

VENDIM
Nr. 145, datë 20.2.2013

PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME PËRFAQËSUES NË SHTABIN “EUFOR”, NË KUADËR TË OPERACIONIT USHTARAK “ALTHEA”, TË BASHKIMIT EUROPIAN, NË BOSNJË-HERCEGOVINË

(Ndryshuar me VKM nr. 396, datë 18.6.2014; nr. 178, datë 25.2.2015; nr. 819, datë 18.12.2019; nr. 37, datë 16.1.2025; nr. 252, datë 10.4.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 pika 5, e 7 të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe të kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të pikave 6 e 11 të nenit 14 të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. *Dërgimin me mision në Sarajevë, Bosnjë-Hercegovinë, në kuadër të operacionit ushtarak “ALTHEA”, të Bashkimit Evropian:*

a) të 1 (një) përfaqësuesi ushtarak të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në shtabin “EUFOR”;

b) të 30 (tridhjetë) ushtarakëve në nivel “togë këmbësorie” nga Forca Tokësore e Republikës së Shqipërisë, në përbërje të kompanisë së pestë të manovrës së batalionit kinetik të Turqisë.

c) të 1 (një) përfaqësuesi të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes në shtabin “EUFOR”.

2. Misioni i përfaqësuesve ushtarak, në kuadër të operacionit ushtarak “ALTHEA”, është drejtimi, monitorimi, këshillimi i Forcave të Armatosura të Bosnjë-Hercegovinës për të gjitha çështjet në lidhje me stërvitjen kolektive, me qëllim implementimin dhe arritjen e aftësive mbrojtëse si dhe garantimi i një mjedisi të sigurt për rritjen dhe forcimin e stabilitetit të shoqërisë në Bosnjë-Hercegovinë.

3. *Kohëzgjatja e këtij misioni është deri në 31 dhjetor 2028. Kohëzgjatja për çdo rotacion është deri në 6 (gjashtë) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me përfaqësuesin e radhës.*

4. Ministria e Mbrojtjes të përballojë, për personelin pjesëmarrës në këtë operacion, shpenzimet për:

a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) siguracion shëndetësor;

- ç) mbështetje shëndetësore;
 - d) shërbimin telefonik dhe internet;
 - dh) transport;
 - e) transportimin e individit të shkëputur të misionit për në atdhe, në rast *thyerje disipline*, vdekjeje ose sëmundjeje;
 - ë) akomodim (fjetje, ngrohje, ujë);
 - f) ushqim;
 - g) energji elektrike, ujë të pijshëm, lavanderi;
 - gj) aktivitete social-kulturore në rastet e festave kombëtare, gjatë kryerjes së misionit;
 - h) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.
5. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet në grup të ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, i cili do të marrë pjesë në këtë mision.
6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara, për çdo vit, në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.
7. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha